



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE  
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHENDETËSOR  
SPITALI RAJONAL SHKODËR**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Shkodër, me \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Riparim mirembajtje I Sistemit ngrohjes se ftohjes” dhe  
“Sistemin e ngrohjes se ujit me panele diellore”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45259000-7**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 32 354 033.33(tridhjetë e dymilion e treqind e pesedhjetë e  
katërmijë e tridhjetë e tre.33) leke pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Shkoder** njesia e prokurimit e perbere nga Brixhilda Lazri, Mimoza Kodra, Dhurata Kameri në zbatim të urdhërit të prokurimit nr 48 datë 02.10.2023 ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*

*b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas shtojcës 2*

*c. Formularin Permbledhes të Vetedeklarimit, sipas shtojcës 9*

*ç. Sigurimin e ofertes, sipas Shtojcës 3 vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur lotit.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit për te cilat oferton (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/a, 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*

Neni 43 pika 3

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Neni 43 pika 5

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore **brenda dates 31 mars të vitit pasardhës,***

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

---

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera,

afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **jo më të vogël se 40%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është ne perputhje me përcaktimet e RRPP neni 41 pika 3:

*3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

Është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **jo më të vogël se 40%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës).

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licensë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godina civile dhe industriale

#### PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS-2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
- NS- 3A Impiante ngritese transportuese .....
- NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-12B Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- NS-13A Impiante dhe linja telefonie e telekomunikacioni
- NS-14 A Impiante të brendshme elektrike, .....

bazuar në VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Në procesin e identifikimit të llojeve të shërbimeve të mirembajtjes, sasive të tyre të nevojshme për çdo lloj shërbimi mirembajtjeje e sidomos e cilesia e kërkuar për të mbajtur një standart të cilesisë së mirembajtjes që do kryhet në Spitalin Rajonal Shkoder nga grupi i punës janë perfunduar me listën e shërbimeve të mirembajtjes që do të kryhen (PREVENTIVI) si dhe shoqëruar me specifikimet teknike respektive për çdo zë në këtë preventiv.

Sherbimet e mirembajtjes që do të kryhen janë shërbime që kërkohen të kryhen me cilësi conform standarteve të cilesisë së shërbimeve të detyrueshme në vendin tonë .

Për të ruajtur cilësinë e pritshme të shërbimeve të mirembajtjes është kërkuar që këto lloj shërbimesh duhet të kryhen nga operatorë që plotësojnë disa kërkesa minimale teknike të kërkuara tashmë rregullisht në Republikën e Shqipërisë për kryerjen e çdo shërbimi.

Duke u nisur nga zërat e shërbimeve në preventiv , ato mund të grupojmë sipas kapitujve në këto lloj shërbimesh :

- A. Riparim i kaldajave
- B. Riparim i bruciatoreve
- C. Riparim i grupit të pompimit të sistemit të ngrohjes

Në këto kapituj ashtu siç janë përshkruar në preventiv dhe në specifikimet teknike janë të gjitha shërbime mirembajtjeje e riparime të sistemeve të ngrohjes që kërkojnë që punëmarresi që do të kryejë këto lloj shërbimesh detyrimisht që të jetë i specializuar nga ana teknike në këtë fushë dhe kjo sjell nevojën e kërkesës ndaj punëmarresit që të jetë i certifikuar (licensuar ) nga organe kompetente për të kryer këto lloj shërbimesh specifike teknike .

Është menduar që punëmarresi për vetë llojet e shërbimeve të mirembajtjes e riparime dhe sasisë së tyre duhet të jetë i licensuar të pakten në kategorinë NS–12B (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit) dhe NS–14 A (Impiante të brendshme elektrike)

- D. Shërbim i fancoileve egzistues dhe zëvendësimi i fancoileve të demtuar

Në këtë kapitull ashtu siç janë përshkruar në preventiv dhe në specifikimet teknike janë të gjitha shërbime mirembajtjeje e riparime të sistemit të F-C tokësor e ,tavanor e të kanalizuar që kërkojnë që punëmarresi që do të kryejë këto lloj punimesh detyrimisht që të jetë i specializuar nga ana teknike në këtë fushë që përshin si shërbime mirembajtjeje e riparime të sistemit të ngrohjes ashtu edhe shërbime mirembajtjeje e riparime të sistemit të Kondicionimit ,dhe kjo sjell nevojën e kërkesës ndaj punëmarresit që të jetë i certifikuar (licensuar ) nga organe kompetente për të kryer këto lloj shërbimesh specifike teknike .

Është menduar që punëmarresi për vetë llojet e shërbimeve të mirembajtjes e riparime dhe sasisë së tyre duhet të jetë i licensuar të pakten në kategorinë NS–12B (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit) dhe NS–14 A (Impiante të brendshme elektrike)

- E. Riparim dhe shërbim teknik periodik i sistemit të kondicionimit me chillera.

Në këtë kapitull ashtu siç janë përshkruar në preventiv dhe në specifikimet teknike janë të gjitha shërbime mirembajtjeje e riparime të sistemit HVAC tokësor e ,tavanor e të kanalizuar ,me mirembajtjeje e riparime të bordeve të kontrollit të tyre në distancë dhe në grup duke përfshirë

zmontimet e paisjeve te renda zbritjen nga lartsite per tu riparuar ,ngritjen e yre per tu montuar rishtas ,ndertimin e shfrytezimin e impianteve ngritese ,dhe qe kerkojne qe punemarresi qe do te kryeje keto lloj sherbimesh detyrimisht qe te jete i specializuar nga ana teknike ne kete fushe qe pershin si sherbime mirembajtje e riparime te sistemve HVAC ,te kontrollit e manaxhimit te tyre , hapjen e vrimave e kanaleve e mbylljen e tyre pas montimit dhe kjo sjell nevojën e kerkeses ndaj punemarresit qe te jete I certifikuar (licensuar ) nga organe kompetente per te kryer keto lloj sherbimesh specifike teknike .

Eshte menduar qe punemarresi per vete llojet e sherbimeve te mirembajtjes e riparimeve dhe sasisise se tyre duhet te jete i licensuar ne kategorine NP-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje NS-4 A Sherbime rifiniture ,NS-12B (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit) , NS-3A Impiante ngritese transportuese ,NS-14 A (Impiante të brendshme elektrike) dhe NS-13A Impiante dhe linja telefonie e telekomunikacioni .

#### F. Riparim i sistemit te prodhimit te ujit sanitar me Panele Diellore

Ne kete kapitull ashtu sic jane pershkruar ne preventiv dhe ne specifikimet teknike jane te gjitha sherbime mirembajtjeje e riparime te sistemit te prodhimit e shfrytezimit te te ujit te ngrohte sanitar nepermjet paneleve diellore , zmontimet e paisjeve te demtuara zbritjen nga lartsite per tu riparuar ose nderruar ,ngritjen e tyre per tu montuar rishtas ,ndertimin e konstruksioneve metalike ,shfrytezimin e impianteve ngritese ,zmontimin nga vendi i gjthe bazamenteve te montuara ne tarrace ,prishjen e hidroizolimit te demtuar egzistues berjen e platformave prej betony per te krijuar mbeshtetje per konstruksionet mbajtese te paneleve diellore, riparimin e hidroizolimit ,hapjen e vrimave e kanaleve e mbylljen e tyre pas montimit dhe qe kerkojne qe punemarresi qe do te kryeje keto lloj sherbimesh detyrimisht qe te jete i specializuar nga ana teknike ne kete fushe qe pershin si sherbime mirembajtje e riparime te sistemve HVAC ,te kontrollit e manaxhimit te tyre ,dhe kjo sjell nevojën e kerkeses ndaj punemarresit qe te jete I certifikuar (licensuar ) nga organe kompetente per te kryer keto lloj sherbimesh specifike teknike .

Eshte menduar qe punemarresi per vete llojet e sherbimeve te mirembajtjes e riparimeve dhe sasisise se tyre duhet te jete i licensuar ne kategorine NP-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godina civile dhe industriale, NS-2 A Impiante hidro-sanitare, NS-4 A Sherbime rifiniture NS-12B (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit) , NS- 3A Impiante ngritese transportuese ,NS-14 A (Impiante të brendshme elektrike) dhe NS-13A Impiante dhe linja telefonie e telekomunikacioni .

#### G. Kontroll e riparime ne sistemin e MNZSH

Ne kete kapitull ashtu sic jane pershkruar ne preventiv dhe ne specifikimet teknike jane te gjitha sherbime mirembajtjeje e riparime te sistemit te MNZ sit e shuarjes me pluhur ashtu edhe me uje ,te riparimeve te pompave te MNZ ,kontrollin e riparimin e sistemit me energji elektrike te tyre per gadishmeri non stop ,riparim I gjithe grupit elektro-diesel qendror te shuarjes me uje ,te hapjen e vrimave e kanaleve ne mure e tavan per riparimin e kasetave te hidranteve te MNZ me uje e mbylljen e tyre pas montimit dhe qe kerkojne qe punemarresi qe do te kryeje keto lloj sherbimesh detyrimisht qe te jete i specializuar nga ana teknike ne kete fushe ,dhe kjo sjell nevojën e kerkeses ndaj punemarresit qe te jete I certifikuar (licensuar ) nga organe kompetente per te kryer keto lloj sherbimesh specifike teknike .

Eshte menduar qe punemarresi per vete llojet e sherbimeve te mirembajtjes e riparimeve dhe sasisise se tyre duhet te jete i licensuar ne kategorine NP-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godina civile dhe industriale, , NS-4 A Sherbime rifiniture NS-12B (Impiante teknologjike,

termike dhe të kondicionimit) , NS- 3A Impiante ngritese transportuese ,NS–14 A (Impiante të brendshme elektrike) dhe NS–13A Impiante dhe linja telefonie e telekomunikacioni .

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit duke përfshirë edhe stafin drejtues duhet të jetë jo më pak se **15(pesëmbëdhjete) punonjës.**

Per kete duhet te paraqese:

- a. Vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- b. List- pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane sherbim ngrohje ftohjeve eshte e nevojshme një staf i kualifikuar. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne nevojen per kryerjen e sherbimeve si dhe natyren dhe numrin e sherbimeve qe kerkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës per realizimin e objektit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht të punësuar, si më poshtë:

Nr.	Stafi	Nr.
1	Drejtues teknik - Inxhinier Mekanik	1 (një)
2	Inxhinier Elektrik	1 (një)
3	Teknik të kaldajave	1 (një)
4	Teknik I ajrit te kondicionuar	1 (një)
5	Hidraulik	1 (një)
6	Elektromekanik	1 (një)
7	Saldator	1 (një)
8	Riparues te sistemeve te ngrohje- ftohjes	1 (një)
9	Riparues të paneleve diellore	1 (një)
10	Instalues i kondicionereve dhe sistemeve te ngrohje ftohjes	2 (dy)
11	Murator	1 (një)
	<b>Total</b>	<b>12(dymbëdhjetë)</b>

a) **Për inxhinierat te paraqitet:**

- Diplomë me profesion Inxhinier Mekanik.
- Kontrate pune perkatese.
- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore(formularet E-sig 025 ) ne tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve”.

b) **Për stafin teknik, te paraqitet:**

- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore(formularet E-sig 025 ) ne tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit per inxhinierin bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve”.
- Kontrate pune (të vlefshme)
- Certifikate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT), e cila duhet te jete e leshuar nga shoqeri te akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

- c) Ne zbatim te akteve ligjore, drejtuesi teknik nuk duhet te figuroje i dy punesuar ne sektor privat apo publik. Per kete Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise te paraqes deklarate perkatese.

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

**Argumentimi:** Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklaroj se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

**Argumentimi:** Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera percaktohet se keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet te cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtoje paisjeve te sistemit HVAC objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete original i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

2.3.7 Operatori ekonomik te jete I pajisur me certificate CE EN ISO 7396-1 ose ekuivalente me ato të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .  
ose

Deklaratë nga Operatori Ekonomik qe eshte I certifikuar sipas standartit CE EN ISO 7396-1 ose Ekuivalente me ato të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certificate ISO 9001-2015 ose ekuivalent, të vlefshme, Çertifikata të jete e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

**Argumentimi:**Keto kritere vihen në përputhje me piken 1 te nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike dhe me pikën 3 të nenit 40 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është i lidhur ngushte me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e shërbimeve ,me qëllim realizimit e objektit të prokurimit:

Nr	Lloji Makinerive	SASIA
1.	Mjet transporti veteshkarkues deri 3 ton (kapac.mbjates)	1 copë
2.	Makineri e levizeshme e specializuar per rimbushje e kolaudim fikse zjarri	1 Cope

Nr	Mjete Pune	SASIA
1.	Aparat saldimi CP3	1 copë
2.	Aparat saldimi me gaz CP5	1 copë
3.	Matrapik	1 copë
4.	Betoniere	1 copë
5.	Skeleri	100 m <sup>2</sup>
6.	Pompe uji	0.5 m <sup>3</sup>
7.	Kthyes tubacioni	1 cope

Si dëshmi per ploteësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

**A.Për mjetet që shënohen në regjistra publikë:**

- Aktet e pronësise se mjeteve, ose kontratat originale ose te noterizuara te marrjes me qira te mjetit,
- Lejet e qarkullimit
- Certifikata e kontrollit teknik
- Siguracioni I mjetit
- Taksat



### **B. Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë,**

- Duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4 të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Zotërimi i mjeteve dhe pajisjeve të mësipërme nga operatori ekonomik ofertues ka si qëllim të sigurojë autoritetin kontraktor mbi aftësitë teknike të operatorëve ekonomikë fitues potencialë, në drejtim të përmbushjes me sukses të kontratës dhe detyrimeve në zbatim të saj, konform standardeve të mirëpërcaktuara në dokumentat e tenderit.

Njesia e Prokurimit